



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 122, datë 30.03.2022**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E POSACME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Irida Kacerja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Nenet 283/a/1-22, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Sokol Shehu (relator), Arbër Çela dhe Hasan Selimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

2. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, {...}; Objekti: “Detyrimi i Bashkisë Sarandë për lejimin e vazhdimet të punimeve, sipas lejes së ndërtimit nr.119, datë 06.10.2010, etj.”

3. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Hazbi Balliu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Paditës: {...}, {...}; Të paditur{...}, etj.; Objekti: “Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e vendimit për dënim me gjobë nr.03, datë 14.07.2021 të vendosur nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Sarandë”.

### **GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 e 334/1 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Florjan Kalaja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 248/25 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 121/a/2 dhe 323/1 të Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 301 i Kodit Penal”.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 284 i Kodit Penal”.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 305, 76 të Kodit Penal”.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...} etj.; Akuza: “Neni 283/a/2 të Kodit Penal”.

## **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Përndjekja”; “Prishja e qetësisë publike”.
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali dhe Genti Dokollari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Vrasje me paramendim”, etj.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.
4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Plagosje e rëndë me dashje”.
5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje e kryer në bashkëpunim”; “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”.
6. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Objekti: “Dërgim në gjyq”.
7. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali dhe Genti Dokollari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: Përmbaruesi gjyqësor {...}; Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Pjesëtim sendi”.
8. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali (relatore), Genti Dokollari dhe Laurent Fuçia, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Kultivimi i bimëve narkotike, etj.”
9. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Genti Dokollari (relator), Margarita Buhali dhe Laurent Fuçia, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Kallëzim i rremë”.

## **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; I pandehur: {...}; Akuza: “Shkatërrim i pronës nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}), etj.; I paditur: {...}; Objekti: “Marrje e masës së sigurimit, ndalimin e punimeve subjektit {...} në malin Gostenckë-Ara Kumbllas, ish Komuna Leshnjë, Skrapar, etj.”

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Kundër: {...}; Objekti: Shfuqizimi i vendimit datë 04.12.2020 të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 1167 viti 2020” etj.

4. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Apelit Vlorë si vijon:

1.) Kërkesës nr. 917 prot., datë 20.12.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me të pandehur{...}, {...}, {...}, {...}; akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**